

AKT THEMELIMI
“Gamax Beauty”
Shpk

*Sot me datë **22.08.2022** në mbështetje të neneve 39-53 të Ligjit nr. 7850, datë 29/07/1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe të ligjit nr.8788 ,date 07/05/2001 themeluesit e shoqërisë hartojnë e Aktin e Themelimit si më poshtë vijon;*

THEMELUES:

Loredana Cataudo, atësia Salvatore, mëmësia Giovanna, shtetase Italiane, lindur në Ivrea dhe banuese në Romë, me adresë Piazza Grazidi Nr.5, Romë (adresa e plote), lindur më 17.03.1968, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 039903 dhe nr. personal CA6282 IIE,

Mirjana Zisi, atësia Zyliftar Zisi, mëmësia Merushe, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 2, BLV: Zhan Dark 027, P.67, Shk. 2, Ap. 9, Tiranë, lindur më 04.11.1959, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 036363227 dhe nr. personal F96104068R,

NENI 1
STATUSI JURIDIK

Shoqëria Tregtare “**Gamax Beauty**” SHPK është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vazhdim referuar si “Shoqëria”). Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Ajo ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2
EMRI I SHOQËRISË, VULA

Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “**Gamax Beauty**” SHPK. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj identifikuese, të cilat do të figurojnë në çdo dokument zyrtar të lëshuar prej saj.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
Tregëtia me shumicë dhe pakicë e produkteve dhe pajisjeve kozmetike.

NENI 4
SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës, në adresën: Rruga Mihal Grameno”, Pall. Mangalem 21, Shkalla nr. 6, Ap.631, Tiranë

NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 50 (pesëdhjetë) lekë.

Znj. Loredana Cataudo zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 50 % të tij në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.

Znj. Mirjana Zisi zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 50 % të tij në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total.

NENI 6
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin e Biznesit. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7
ORGANET DREJTUESE

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë “Gamax Beauty” SHPK., është **Znj. Suela Zisi** atësia Gligor, amësia Mirjana, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë: Njësia Bashkiake Nr. 2, BLV: Zhan Dark 027, P.67, Shk. 2, Ap. 9, Tiranë, lindur më 11.04.1983, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034881702 dhe nr. personal I35411059L, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8
LIGJI I APLIKUESHËM


Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortakët Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

THEMELUES:

Loredana Cataudo



Mirjana Zisi

